

KËRKESË
Nr. 362/14, datë 27.9.2023
PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private të cilat preken nga ‘Ndërtimi i Institutit të Policisë Shkencore’”.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit “ndërtesë” dhe “njësi”, bazuar në pikën 3, të VKM-së nr. 138., datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, sipas tabelës bashkëlidhur.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit 6,278,426.40 (gjashtë milionë e dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e katërqind e njëzet e gjashtë pikë dyzet) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Egra Ibrahim

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI “NDËRTIMI I INSTITUTIT TË POLICISË SHKENCORE”,
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHQETIT

NR.	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKORE						"NDERTESE"				SHËNIME (D+E) (Kufizime hipotekore, barrë mbi pasuritë etj.)	
	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	Fahati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja Totale	Ndërtesë (m²)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera sipas situacionit (lekë)	VLERA TOTALE (lekë)		
1	AGIM VJOSA KUJTIM	ISMAIL RIDVAN MYNIR	CANI SKENDO KRVEZIU	TIRANË	8240	3/168-ND	NDERTESE	68.53	68.53	68.53	65,000	4454450.00	4,454,450.00	Shëtit është pronar i tualtit 3/127 V.2/E.173, mbi të cilin ndodhet ndërtesa 3/168. Diferenca dokument - fakt është 15 m². Kufizim veprimesh deri në zgjidhjen e marrëdhënieve me tuallin	
2	AGIM VJOSA KUJTIM	ISMAIL RIDVAN MYNIR	CANI SKENDO KRVEZIU	TIRANË	8240	3/170-N1	NJËSI	176	176	176	vlerësim sipas ekspertit	1,823,976.40	1,823,976.40	Shëtit është pronar i tualtit 3/127, mbi të cilin ndodhet ndërtesa 3/170-N2. Kufizim veprimesh deri në zgjidhjen e marrëdhënieve me tuallin	
SHUMA PARAPRAKE														6,278,426.40	